



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:012474

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05747235

KPPP.nr.76/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përbarimore të kreditorit “Tire Center” SH.P.K., me NRB:71087875, me seli në Ferizaj, rruga “Rexhep Bislimi”, kundër debitorit “Betoni & MB” SH.P.K., me NUI:811047051, me seli në Ferizaj, Dardani, përfaqësuar sipas autorizimit nga Jeton Berisha, avokat nga Ferizaj, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.649/2023 të datës 15.12.2023, të Përbaruesit Privat Besnik H. Aliu, me seli në Ferizaj, jashtë seancës, me datë 28.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Betoni & MB” SH.P.K., ANULOHET Urdhri Përbarimor P.nr.649/2023 i datës 15.12.2023, i Përbaruesit Privat Besnik H. Aliu, dhe PËRFUNDOHET në tërësi përbarimi në këtë çështje përbarimore.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrit Përbarimor P.nr.649/2023, të datës 15.12.2023, me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturën Nr.21-SHV01-001-576 të datës 06.04.2021, me të cilin është urdhëruar debitori që t’ia paguaj kreditorit shumën 290.00 €, me kamatë ligjore deri në përmbushjen definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, nën kërcënimin e përbarimit me dhunë, me bartjen e mjeteve financiare nga llogaria bankare e debitorit në llogarinë e veçantë bankare të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se debitori e ka paguar në tërësi borxhin që në momentin e pranimit me datë 06.04.2021, andaj propozimi i debitorit është i pabazuar pasi që i njëjti bazohet në një faturë e cila tashmë është e paguar e cila vërtetohet nga dëshmia e pagesës nga BPB. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbartimore ta anuloj, si dhe të detyrohet kreditori që debitorit t'ia kompensoj të gjitha shpenzimet e përpilimit të prapësimit si dhe shpenzimet e tjera.

Kreditore në përgjigje në prapësimi ka deklaruar se, debitori nga shuma totale e faturës prej 2,520.00 € ka mbetur borxh vetëm për shumën prej 390.00 €, pasi që pjesën tjetër është e vërtet që e ka paguar, ndërsa nga dëshmia e pagesës të cilën e ka bashkangjitur debitori llogaria në të cilën e ka kryer transferin është llogari jo aktive e kreditorit të cilën nuk e përdor më. Tutje ka shtuar se fatura e cila është objekt i kësaj procedure përmbartimore i plotëson të gjitha kushtet sipas LPP-së, andaj nuk është plotësuar asnjë kusht për anulimin e urdhrin përmbartimor. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj prapësimin e debitorit, si dhe ta vërtetoj urdhrin përmbartimor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (tutje LPP), gjeti se prapësimi është në tërësi i bazuar për shkaqet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se borxhi i kërkuar nga kreditore me propozimin për përmbartim dhe i lejuar me urdhrin e Përmbartuesit Privat Besnik H. Aliu, P.nr.649/2023 të datës 15.12.2023, në shumën prej 290.00 €, është përmbushur në tërësi.

Gjykata duke u bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës, përkatësisht nga dëshmia e pagesës e datës 06.04.2021, vërtetoi faktin se debitori e ka përmbushur detyrimin në shumën prej 2,520.00 €, sipas Faturës Nr.21-SHV01-001-576 të datës 06.04.2021, për të cilën është iniciuar propozimi për përmbartim dhe është lëshuar urdhri përmbartimor, andaj vlerësoi se prapësimi i debitorit është në tërësi i bazuar dhe duke u mbështetur në nenin 71 par.1 nën par.1.2, të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbartues ose urdhri përmbartues është prishur anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër,*

gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, pasi që fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, e ka humbur efektin juridik, sepse e njëjta është përmbushur në tërësi nga ana e debitorit.

Andaj bazuar në faktin se debitori e ka përmbushur detyrimin e tij ndaj kreditorit, gjykata vlerësoi se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe duke u mbështetur në nenin 66 par.4 të LPP-së me të cilin përcaktohet se: *“Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore”,* përfundoi në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

Gjykata në kuptim të nenit 66, nenit 71 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.76/24, datë 28.05.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.